



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 145, datë 28.09.2023

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "HYSEN MYSHKETA" PALLATI NR. 30, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. 6902/2 prot., datë 14.09.2023, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.30, Njësia Administrative Nr.3, rruga "Hysen Myshketa", i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

## KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.09.2023



**ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.30, RRUGA "HYSEN MYSHKETA"**

<b>Nr.</b>	<b>PRONARI</b>	<b>GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES</b>	<b>STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET</b>
1	LUAN QALLIAJ	3	2+1
2	PULLUM BUKA, ENKELEJDA BUKA	4	2+1
3	ROLAND NASKA, MITI NASKA	4	2+1
4	LINDITA KATRELI	7	3+1
5	MUHAMET LLANI	3	2+1
6	SOKOL LLANI	4	2+1
7	FATION XHYVELAJ	6	3+1
8	XHULJETA SHKARPA, PETRAQ SHKARPA	1	1+1
9	GJON SHTJEFNI, VALDETE SHTJEFNI	2	1+1
10	AVNI BRATI	2	1+1
11	AGIM XHAMXHIU, ABIBE XHAMXHIU	2	1+1
12	LINDITA MEMA	5	3+1
13	VJOLLCA GRABOVA	2	1+1
14	ASTRIT CANAJ	2	1+1
15	ALBANA SELIMI	4	2+1
16	KUJTIM KALOTI	4	2+1
17	JORGJI PETANI, ALEKSANDRA PETANI	3	2+1
18	BUJAR ZDRAVA	3	2+1
19	LUCIJE KALOTI	3	2+1
20	JETA SHEHU	1	1+1
21	ALBERT LLANI	4	2+1
22	ILIAZ HOXHA, PAJTIME HOXHA	4	2+1
23	GEZIM HYSENI, ILIR HYSENI	9	3+1



BASHKIA Durrës  
05/10/23 Nr 8621/5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 629/3 Prot.

Durrës, më 05.10.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.145 datë 28.09.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë Administrative nr.3, rruga “Hysen Myshketa” pallati nr.30, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore të tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

